



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 38
Prishtinë, më 12.10.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Fidan Rekaliu, Arbërie Nagavci, Driton Çausi dhe Abdyl Salihu.

Munguan: Valentina Bunjaku-Rexhepi, Mufera Shinik, Verica Çeraniq, Albulena Balaj-Halimaj dhe Nezir Çocaj,

Përfaqësues të tjerë: Shiqyri Bytyçi, ministër i MASHT, përfaqësues të KDI-së dhe mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri, Shaip Goxhuli dhe Rudinë Fetahaj.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8.10.2018;**
- 3. Raportimi i ministrit të Arsimit lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe fillimin e vitit shkollor 2018/19;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8.10.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 8.10.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i ministrit të Arsimit lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe fillimin e vitit shkollor 2018/19

Ismajl Kurteshi, tha se përkundër faktit që ka kaluar një kohë e gjatë, që kur ka përfunduar viti shkollor dhe një muaj e më shumë nga fillimi i vitit të ri shkollor dhe atij universitar, komisioni nuk ka pranuar asnjë raport nga MASHT-i, lidhur me këto çështje, andaj kjo është arsyeja që është ftuar ministri për të raportuar.

Shyqiri Bytyçi, tha se viti i kaluar shkollor ka përfunduar me sukses, sipas afatit të paraparë në kalendarin shkollor. Ministri veçoi organizimin me sukses të Provimit të Maturës Shtetërore, ndërsa tha se po shikohen mundësitë për hapjen e një debati të mirëfilltë, i cili do të ndikonte në rritjen e cilësisë së këtij provimi, në të gjitha aspektet.

Ndërsa, sipas tij, viti i ri shkollor ka filluar sipas kalendarit shkollor 2018/2019, i cili ka filluar me sukses, përveç në 9 shkolla, ku mësimi ka filluar me vonesë, për shkak të punimeve që nuk janë përfunduar me kohë, por që orët e humbura në këto shkolla do të kompensohen. Në vazhdim, tha se po vazhdon zbatimi i kurrikulës së re, ndërsa përmendi faktin se është shpallur konkursi për tekste të reja shkollore, për të cilat tha se do të jenë tekste bashkëkohore, konform Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe do të jenë të gatshme në fillim të vitit të ri shkollor. Ndërsa, për këtë vit, janë në përfundim e sipër udhëzuesit për mësimdhënës për përdorimin e teksteve të vjetra, duke i harmonizuar me kurrikulat e reja.

Ministri përmendi se edhe këtë vit janë shpërndarë tekstet falas për nxënësit nga kl.1-9, sipas kërkesave të drejtorive komunale të arsimit. Ai foli për fillimin e procesit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, ndërsa shtoi se për rëndësinë e këtij procesi ka marrë vlerësime pozitive edhe nga institucione dhe ekspertë të arsimit gjatë vizitës zyrtare në SHBA.

Ministri theksoi se sa i përket arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, është shënuar edhe një e arritur, duke qenë se këtë vit do të punësohen 100 asistentë, por tha se po shikohen mundësitë që në këtë drejtim të angazhohen edhe studentët e Fakultetit të Edukimit. Duke folur për arsimin dhe aftësimin profesional, ministri theksoi se po bëhen përpjekje që të krijohen më shumë mundësi për organizimin e punës praktike, sepse për herë të parë, këtë vit, me kërkesën dhe argumentimin e MASHT-it, është miratuar buxheti shtesë prej 1 milion euro, që do të shërbejë për realizimin e praktikës profesionale me mjete bashkëkohore. Ai raportoi edhe për zhvillimet në arsimin e lartë, ku ndër të tjera përmendi hartimin e udhëzimit administrativ, me të cilin rregullohet çështja e regjistrimit të studentëve të rinj.

Me qëllim të ngritjes së cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit, ministri Bytyçi përmendi edhe shumë hapa që janë ndërmarrë, ose që janë duke u planifikuar, duke përfshirë funksionalizimin e Këshillit Kombëtar të Cilësisë, çështjen e zgjedhjes së drejtorëve të shkollave, me qëllim depolitizimin e arsimit, akreditimin e programeve të shkollave të mesme profesionale.

Megjithatë, ministri theksoi nevojën e rritjes së buxhetit, në mënyrë që të realizohen synimet e përbashkëta për ngritjen e cilësisë në arsim.

Ministri Bytyçi përmendi edhe çështjen e ristrukturimit funksional të MASHT-it, si ministria e parë që i është nënshtruar këtij procesi, ndërsa theksoi se tashmë është filluar puna me implementimin e organogramit të ri, të miratuar javën e kaluar.

Ismajl Kurteshi, tha se në një raport që kanë pranuar nga MASHT për përfundimin e vitit shkollor, shkruhet vetëm që viti shkollor 2017/18, ka përfunduar me sukses, mirëpo që komisioni pret, në një afat sa më të shkurtër, një raport më të detajuar lidhur me numrin e nxënësve, suksesin e tyre, numrin e mungesave etj. Ai kërkoi nga ministri informata rreth ngritjes së kapacitetit të buxhetit, duke qenë se ka ende prindër që në institucione publike i paguajnë mësuesit e edukimit parashkollor dhe që një gjë e tillë nuk do të duhej të ndodhte.

Ai, gjithashtu, tha se në një raport që komisioni ka pranuar nga Agjencia e Aftësisimit Profesional dhe Arsimin për të Rritur, është mësuar se ata e kanë bërë një kontratë me Maltën, ku i kanë dërguar 9 nxënës në trajnim dhe një me Gjermaninë, ku i kanë dërguar 21 nxënës në trajnim, por asnjëherë nuk kanë treguar se sa nxënës ndjekin mësimin në shkollat profesionale dhe sa prej tyre kanë mundësi të ushtrojnë praktikën në laboratorë, në ndërmarrje të ndryshme. Po ashtu, ai tha se do të ishte mirë sikur të kishte informata të sakta për gatishmërinë e mësimit për të ndihmuar nxënësit në punë praktike. Më tej, tha se në raportin e MASHT-it për periudhën janar – qershor 2018, kanë munguar informata të rëndësishme, si p.sh. deri ku ka arritur procesi i ristrukturimit të MASHT-it, përse Divizioni i Programeve është dashur që bashkë me DZHPM dhe koordinatorët e kurrikulave, ta bëjnë rishikimin e udhëzuesve për zbatimin e kurrikulës sipas fushave. Ai, gjithashtu, tha se shumë institucione të arsimit të lartë privat nuk i kanë dorëzuar librat amë brenda afateve ligjore dhe të njëjtit punojnë pa asnjë pengesë dhe që MASHT-i nuk ka ndërmarrë diçka. Studentët e këtyre kolegjeve, thuhet se vijnë në MASHT për t'i vulosur këto dokumente dhe që MASHT-i nuk ka ide se çfarë po ndodh, shtoi ai. Gjithashtu, ai theksoi se një pjesë e mirë e institucioneve privatë të arsimit të lartë, ofrojnë programe të pa-akredituara, duke shkaktuar kështu probleme për studentët që përfundojnë këto studime, duke vazhduar që këto kolegje private të regjistrojnë studentë, pa numër amzë dhe jashtë afatit ligjor të regjistrimit të studentëve. Ai kërkoi të dijë se çka ka bërë MASHT-i, për t'i hequr nga përdorimi pjesët e plan-programeve të Serbisë, me të cilat mësojnë minoritetet në Kosovë e që mbjellin urrejtje ndërnacionale. Po ashtu, tha se është vërejtur një mungesë e komunikimit në mes të MASHT-it dhe qytetarëve të Kosovës, duke përmendur rastin e disa studentëve që kanë përfunduar studimet në Kolegjin “Kristal” të Shqipërisë dhe që kanë kërkuar informata për vazhdimin e studimeve në Kosovë, mirëpo që askush nga MASHT-i nuk ishte treguar i gatshëm t’iu ndihmojë.

Në vazhdim, ngriti çështjen zbatimit të ligjit të inspektoratit të arsimit nga inspektorët e arsimit, të cilët, sipas tij, janë duke neglizhuar përgjegjësitë e tyre, me arsyetimin që ligji aktual nuk i mbulon disa fusha të caktuara. Po ashtu, ai tha se në një shkollë në Abri, ka 6 javë që fëmijët nuk po shkojnë në shkollë, përkundër faktit që shteti është i obliguar t’iu sigurojë nxënësve kushte të mësimin. Gjithashtu, përmendi çështjen e truallit të Universitetit të Prishtinës, që për shkak të neglizhencës institucionale, i është falur kishës ortodokse.

Teuta Haxhiu, tha se vendimi për asistentët të Fakultetit të Edukimit është i duhur, mirëpo që këta studentë duhet të stimulohen edhe me vende të punës apo që praktika e studentëve të njihet si përvojë pune. Ajo tha se është me rëndësi që përzgjedhja e drejtorëve të shkolla të

depolitizohet. Duke filluar nga arsimi i ulët, saktësisht në shkollën e mesme të ulët “Ganimete Tërbeshi” në Mitrovicë, ajo përmendi kushtet e mjerueshme, në të cilat kjo shkollë mban mësim dhe që duhet ndërmarrë hapa për të ndryshuar këtë fakt. Gjithashtu, duke theksuar faktin që ministria ka një buxhet për trajnimin e mësimdhënësve dhe duke marrë parasysh që ministria bashkëpunon me shumë organizata të ndryshme, të cilat edhe financohen nga vetë ministria, ajo shprehu shqetësimin e saj për pagesat e mësimdhënësve, prej 250 eurosh, për të ndjekur këto trajnime. Sa i përket teksteve mësimore, ajo tha se ka shkolla që përmes mjeteve të informimit, kanë deklaruar që nuk i kanë tekstet shkollore.

Gjithashtu, tha se ka shumë shqetësime nga ana e prindërve për mosregjistrimin e fëmijëve të tyre në gjimnaze, edhe me sukses të shkëlqyeshëm, ndërsa theksoi se shkollat profesionale po mbesin mbrapa edhe me numër të nxënësve. Ajo kërkoi nga ministri sqarime se çfarë po bëhet në këtë drejtim, për të përmirësuar këtë gjendje dhe për t'i bërë më atraktive, sepse do të përfitonte edhe vendi e jo vetëm shkollat. Ajo propozoi që MASHT të shpallë shkolla profesionale, në të gjitha rajonet e Republikës së Kosovës, me interes kombëtar, nën ombrellën e MASHT-it.

Tutje, ajo përmendi mësimdhënësit që kanë probleme të rënda shëndetësore dhe kërkoi të dijë se çfarë po ndodh në këtë drejtim. Për fund, ajo tha se gatishmëria e komisionit është që t'i ndihmojë jo vetëm MASHT-it, si ministri, por të gjithë vendit, duke theksuar edhe përpjekjet për rritje të buxhetit.

Arbërie Nagavci, kërkoi që raportet e punës së ministrisë të përcillen më herët tek anëtarët e komisionit dhe të jenë më të plota dhe pa gabime drejtshkrimore. Ajo përmendi udhëzimin administrativ për normativin dhe kërkoi sqarime se pse një udhëzim administrative që Ministria e ka publikuar në ueb faqe, e ka tërhequr të njëjtin brenda 2 orësh dhe ka publikuar një udhëzim të ri. Gjithashtu, ajo parashtrroi pyetjen se a janë shqyrtuar ankesat në raport me udhëzimin administrativ, sepse sipas saj, palët me interes kanë kontaktuar ministrinë, sa i përket mangësive të këtij udhëzimi administrativ.

Në anën tjetër, ajo përmendi çështjen e programit të sociologjisë apo të edukatës muzikore, ku në udhëzimin administrativ, përparësi kanë të gjithë ata që kanë përfunduar Master në Fakultetin e Edukimit, edhe pse ky fakultet nuk ka Master të këtij profili, duke kërkuar sqarime se pse po ndodh kjo. Për më tepër, ajo tha se a është analizuar sesi ky udhëzim administrativ ka ndikuar në komuna të ndryshme, sepse udhëzimi i kaluar ka pasur një afat që të gjithë mësimdhënësit, deri në vitin 2018, të përfundojnë Masterin, përndryshe do të hapen vende të reja. Ajo tha se disa komuna ua kanë ndërprerë kontratën disa mësimdhënësve që nuk kanë pasur të përfunduar Master, ndërsa disa të tjera jo. Kjo gjë është shfrytëzuar nga drejtorët për të punësuar persona të tjerë.

Sa i përket shkollave profesionale, ajo shtroi pyetjen se ku ka mbetur procesi i akreditimit të këtyre shkollave, sepse është një afat i caktuar që mund të rrezikojë procesin e referencimit dhe mosnjohje të diplomave në vendet evropiane. Duke marrë parasysh që disa libra u janë dërguar fatosave të Malit të Zi, ajo kërkoi informata se a ka ndodhur e njëjta gjë edhe në Luginë, pasi që veç është aktuale edhe çështja e shkëmbimit të territoreve. Po ashtu, tha se sigurimi i 100 asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara është një hap shumë pozitiv, duke pyetur se sa ministria është siguruar për të shpallur konkurs dhe të hapë vende të punës, si dhe shkollat duhet të kenë asistentët e tyre, që paguhen nga shteti e jo nga prindërit e fëmijëve.

Driton Çausi, iu bashkëngjiti kërkesës së parafolësve për një raport të mirëfilltë, me informata më të sakta. Ai përmendi çështjen e testit të maturës dhe universitetet publike dhe kërkoi të dijë se a ka ministria një vlerësim të brendshëm të procesit të testit të maturës për të parë se a ka pasur ndonjë ndikim pozitiv ky test në procesin mësimor në Kosovë, për të cilin shfaqti dyshimet e veta. duke mos mohuar ndryshimet e lehta që kanë ndodhur këtë vit në cilësinë e testit, ai tha se vit pas viti është përsëritur i njëjti gabim dhe që shumë padrejtësi kanë ndodhur ndaj nxënësve të caktuar.

Sa i përket universiteteve publike, ai tha se përveç Universitetit “Hasan Prishtina”, janë hapur pa ndonjë strategji të veçantë dhe gjithnjë në prag të zgjedhjeve parlamentare. Ai tha se përveç studentëve që kanë pësuar nga hapja e këtyre universiteteve, është edhe Universiteti “Hasan Prishtina” që ka pësuar shumë, sidomos për nga cilësia. Gjithashtu, ai theksoi që raporti student-profesor nuk është i duhuri, pasi që ka universitete me numër të madh të studentëve, mirëpo me numër shumë të vogël të stafit, duke marrë shembull Universitetin e Prizrenit. Duke iu drejtuar ministrit, ai tha se a besoni që duhet ndodhur një proces i rivlerësimit për hapjen e këtyre universiteteve, funksionimin e tyre dhe për gjendjen në të cilën ndodhen.

Fidan Rekalii, parashtrori pyetjen se sa është numri i nxënësve në nivel vendi që kanë braktisur shkollat, duke u bazuar në raportimin e ministrit që deri në vitin 2019, Kosova do të ketë tekste cilësore, me standarde ndërkombëtare dhe shprehu shqetësimin e tij që tekstet shkollore aktuale nuk e kanë cilësinë e duhur. Ai, gjithashtu, kërkoi informata se çfarë është bërë për të furnizuar nxënësit shqiptarë me tekste shkollore në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc.

Ismajl Kurteshi, ngriti çështjen e themelimit të Institutin Kosovar për Shkencë dhe Teknologji, duke pasur parasysh se të njëjtit profesorë, që e kanë iniciuar themelimin e këtij instituti, kanë kontaktuar MASHT-in, por nuk kanë marrë përgjigje. Çfarë është bërë në këtë drejtim? Një çështje tjetër që është konsideruar shqetësuese, është fenomeni i angazhimit të profesorëve të profileve joadekuate. Ai tha se ka dëgjuar raste që profesorë që kanë përfunduar shkencat politike, ligjërojnë pedagogji ose ka përfunduar doktoratën në siguri dhe ligjërojnë ekonomi, kurse njerëzit që kanë punuar dhe janë të kualifikuar, janë përjashtuar. Për fund, ai shtoi se ende ka shkolla që punojnë me tre ndërrime dhe luti ministrin që në buxhetin e vitit 2019 të parashihet ndërtimi i shkollave në komunat ku mësimi zhvillohet në tre ndërrime. Ai, gjithashtu, i bëri thirrje ministrisë, që të mos lejojë drejtoritë komunale të ndërmarrin vendime që mund të dëmtojnë procesin mësimor.

Shyqiri Bytyçi, lidhur me çështjet e ngritura sa i përket buxhetit, tha se akoma nuk është finalizuar dëgjimi i fundit me Ministrinë e Financave, mirëpo përkundër shumë kërkesave në draftin e buxhetit, ministria nuk është në gjendje të mirë nga aspekti buxhetor dhe që sipas tij nuk do ta kalojë 7% të buxhetit të vitit të kaluar. Ai tha se maksimumi mund të shkojë deri në 10%, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Gjithashtu, ai u shpreh se ministria është e vetëdijshme që buxheti i Kosovës është i kufizuar, mirëpo, fatkeqësisht, arsimit nuk ka qenë asnjëherë prioritet buxhetor.

Për shkollat që punojnë në tre ndërrime, ai tha se investimet kapitale i përmbajnë investimet e vjetra dhe që shumë pak hapësirë do të kenë projektet e reja. Ai tha se për shkak të mosplanifikimit të duhur, ka shkolla që kanë mungesë nxënësish dhe ka komuna që kanë mungesë shkollash. Sa i përket shkollave profesionale, ai tha se ministria po mundohet të ndajë buxhetin dhe t'i bëjnë sa më atraktive këto shkolla, duke angazhuar ekspertë ndërkombëtarë, të cilët kanë ndërtuar 15 standarde, të bazuara në Komisionin Evropian, që do të jenë ndihmesë shumë e

madhe për shkollat profesionale. Po ashtu, ai theksoi janë realizuar disa marrëveshje me biznese, që të kryhen praktikat në këto biznese. Ai tha se jemi në hap pozitiv për avancimin e këtyre shkollave, mirëpo që ka mungesë buxheti. Ministri tha se do të realizohet një pyetësor për matjen e nevojave të bizneseve dhe fushat në të cilat kanë nevojë, në mënyrë që edhe investimi në shkollat profesionale të përkojë me ato fusha. Ai përmendi GIZ-in dhe LUX-in, si partnerë që ofrojnë ndihmë të madhe, në këtë drejtim, duke sjellë praktika të ndryshme.

Lidhur me çështjen e librave amë që nuk janë dorëzuar, ai tha se i përket viteve të kaluara, përkatësisht 2014-2015, që nuk i kanë dorëzuar në MASHT dhe që deri tani nuk është ndërmarrë diçka që studentëve t'iu njihet diploma. Ai tha se janë ngritur dy komisione, për të vlerësuar gjendjen e këtyre diplomave dhe për të siguruar një zgjidhje për këta studentë, si dhe për të parë nëse janë regjistruar në afatet ligjore të universiteteve. Ai tha se shumë probleme janë bartur nga vitet e kaluar dhe duhet shumë punë për t'i tejkaluar. Gjithashtu, ai theksoi që ministri i kaluar e ka hequr udhëzimin administrativ, që kolegjet t'i dorëzojnë librat amë, mirëpo që është kthyer përsëri. Ai tha se shumë studentë, jo vetëm nga kolegjet private, por edhe nga universitetet publike kanë diplomuar nga programe të paakredituara dhe ministria është duke u munduar të gjejë zgjidhje për këtë problem të trashëguar. Sa i përket regjistrimit të studentëve, jashtë afatit të caktuar, ai tha se këtë vit është caktuar afati ligjor i regjistrimit të studentëve dhe që është shumë më lehtë të merren masa për ato universitete/kolegje që nuk i kanë respektuar, pasi që në të kaluarën nuk ka pasur ligjërisht afat të caktuar për regjistrimin e studentëve. Ai tha se çdo studentë i regjistruar, më vonë se 5 tetor 2018, nuk njihet si student i pranuar nga MASHT-i për vitin 2018/19 dhe që janë përcaktuar masat ndëshkuese, së bashku me Agjencinë e Akreditimit, për mosrespektimin e këtij afati dhe të afatit për dorëzimin e librave amë.

Sa i përket, mospërgjigjes me kohë të pyetjeve dhe kërkesave të ndryshme, ai tha se ministria pranon gjatë gjithë kohës një numër të madh të pyetjeve dhe gjithmonë mundohet që të jetë e përpiktë, mirëpo për shkak të numrit shumë të madh të tyre, disa nga pyetjet mund të vonohen për t'iu përgjigjur. Ai tha se të gjithë ata që përfundojnë Master ose Doktoratë, brenda 60 ditëve iu nostrifikohet diploma, gjë që më herët ka marrë një periudhë shumë më të gjatë kohore. Ndërsa, për të diplomuarit nga Universiteti "Kristal", ai tha se me shumë gjasë, përgjigjja do të jetë negative, sepse është një universitet shumë problematik, mirëpo nuk përjashtohet mundësia për ata që kanë përfunduar studimet, në mënyrë të rregullt.

Për shkollën në veri të Mitrovicës, ministri tha se fatkeqësisht nuk ka informacione të mjaftueshme, edhe pse kjo situatë i takon nivelit komunal, mirëpo nëse DKA e Mitrovicës ka nevojë për ndihmë, ministria është e gatshme ta ndihmojë. Lidhur me çështjen e trajnimeve të mësimdhënësve ai tha se ministria është duke u munduar që të i trajtojë këto probleme një nga një fillimisht duke ndërprerë çdo thirrje për trajnim nga organizatat joqeveritare dhe që të gjitha trajnimet e mësimdhënësve, tash e tutje, do të realizohen në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit.

Sa i përket teksteve shkollore, ministri tha se asnjë ankesë nuk ka ardhur në ministri, nga ndonjë shkollë ose komunë për mungesë të librave. Ai theksoi se mund të ketë pasur gabime në raportim të numrit të nxënësve ose ndonjë gabim teknik, mirëpo që është siguruar që përmes mjeteve të informimit, iu bëjë thirrje edhe prindërve, edhe mësimdhënësve, t'i drejtohen DKA-së, me kërkesë zyrtare për mungesë të librave.

Për mësuesit e sëmurë, ministri tha se në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, është duke u punuar udhëzimi administrativ, ku do të krijohet hapësira për zgjidhjen e këtij problemi, duke

theksuar se çdo punëtor që nuk është në gjendje të kryejë punën, do të bëhet zgjidhja e pensionit të parakohshëm. Pas finalizimit të udhëzimit administrativ, ai tha se nga DKA do të kërkohen numrat e saktë të punëtorëve të sëmurë dhe do sigurohet një zgjidhje.

Ministri u dha të drejtë deputetëve për kërkesën e raporteve më të thukëta dhe në kohë, si dhe tha se ministria do ta ketë parasysh këtë vërejtje. Sa i përket ristrukturimit, ai tha se është bërë një punë e mirë dhe që organogrami i ri është miratuar nga Qeveria, së bashku me Rregulloren e të drejtave të punës dhe tani, ministria është në zbatim, shumë divizione janë fuzionuar, shumë departamente janë zvogëluar dhe është bërë një ripërshkrim i detyrave dhe për rrjedhojë një numër i madh i drejtorëve kanë humbur vendin e punës. Ai tha se për përzgjedhjen e kandidatëve të rinj, në konkursin e brendshëm, është duke u bërë përpjekje për t'u formuar një komision të pavarur shumë profesional dhe ndërkombëtar, të cilët do të jenë vëzhgues të këtij procesi. Për më tepër, ai theksoi se nëse gjatë këtij procesi nuk do të plotësohen të gjitha vendet e punës, për shkak të moskualifikimeve adekuate, do të shpallet konkurs i jashtëm, ku përsëri një komision i pavarur do të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve adekuatë.

Për akreditimin e shkollave profesionale, ai tha se është ngritur një grup profesional, që vazhdimisht është marrë me validimin e shkollave profesionale dhe që shumë shkolla kanë aplikuar për validimin e programeve të tyre dhe që janë duke u bërë përgatitje për raportimin në Këshillin e Validimit në Evropë.

Përtej vullnetit dhe dëshirës, për të dërguar libra në Luginë, ai tha se ministria nuk ka pasur hapësirën për të dërguar libra në këto komuna. Ai tha se nuk ka qenë i gatshëm të dërgojë libra, që do të mbesin në kufi për një periudhë të gjatë dhe që pastaj do të paguhej vetëm kostoja. Ministri tha se është duke u shikuar mundësia që përmes Tiranës të dërgohen këto libra, mirëpo nëse edhe kjo mundësi nuk do të funksionojë, për shkak të problemeve politike, nuk do të ketë mundësi të dërgohen këto libra.

Në anën tjetër, sa i përket normativit, ai tha se udhëzimi është tërhequr, për shkak të gabimeve teknike dhe është publikuar i njëjti, pas përmirësimit të gabimeve. Ai theksoi se ky udhëzim nuk ka pasur ndryshime nga vitet e kaluara, përveç viteve që janë paraparë, që mësimdhënësit të fitojnë titullin Master deri në vitin 2018, përndryshe do t'u shpallet vendi i punës. Përkundër faktit që i janë dhënë 3 vite kohë, për të përfunduar këto studime, ministri tha se është siguruar që mësimdhënësve u janë krijuar kushtet e duhura për marrjen e këtij titullim sepse nëse nuk krijohen kushtet, është e palogjikshme t'u humbet vendi i punës dhe kjo ka qenë arsyeja pse është marrë vendimi në udhëzim administrativ, që kjo periudhë të zgjatet edhe për tre vite tjera, derisa të krijohet mundësia për të fituar titullin Master, theksoi ai.

Për të sqaruar dyshimet e parashtruara, ministri tha se asnjëherë Fakulteti i Edukimit nuk ka më shumë përparësi se fakultetet tjera. Me standarde të reja, në 2013, është kërkuar që mësimdhënësit, pas përfundimit të studimeve të nivelit Bachelor, niveli Master të bëhet në nivelin pedagogjik, sepse më nuk do të ketë mësimdhënës që do ta përfundojnë vetëm pjesën profesionale e jo pedagogjike, mirëpo që nuk do të rrezikohen ata, të cilët e kanë përfunduar Master-in, pa hyrë në fuqi ky udhëzim administrativ, sqaroi ai. Gjithashtu, ai theksoi se pjesa pedagogjike i është besuar fakultetit të Edukimit, prandaj që kjo është arsyeja pse në këtë rast ky fakultet ka më shumë përparësi.

Sa i përket testit të maturës, ai tha se ky test nuk mjafton për ta matur dijen e nxënësve dhe shërben vetëm për t'u regjistruar dhe duhet definuar saktë, qëllimi i tij, për shkak se ky test nuk i

përmbush standardet për ta shpërblyer ose jo një të ri, për t'u regjistruar në universitet. Ai tha se janë bërë bisedime me Organizatën e Uashingtonit, që merret me testim dhe që janë të gatshëm të na ndihmojnë, në këtë proces.

Lidhur me universitetet publike, ai tha se pajtohet që duhet bërë rivlerësimi i tyre, mënyra sesi janë hapur, punën që po e bëjnë dhe që është krijuar një grup profesional që merret me vlerësimin e gjendjes së këtyre universiteteve dhe me rekomandime të nevojshme. Gjithashtu, ai tha se këto universitete janë larg nga Universiteti i Prishtinës, dhe njëra nga rekomandimet, ka qenë që ose të shndërrohen në dy universitete të mëdha publike që kanë edhe programe tjera, ose të riorganizohet profilizimi i këtyre universiteteve. Përkundër kësaj, ai tha se ka pasur shumë presione, nga palë të tjera, që kjo gjë të mos ecë tutje dhe që ky raport ka mbetur i pazbatueshëm, sepse nuk po gjen mirëkuptim për zbatim. Mirëpo, ministri tha se është krijuar një grup me ekspertë profesionalë, për të hartuar një strategji për arsimin e lartë, ku do të përfshihen edhe kolegjet private e deri tek universitetet publike, duke u fokusuar edhe në programet që ofrojnë dhe duke synuar që këto programe të përputhen me kërkesat e tregut.

Lidhur me numrin e saktë të nxënësve që kanë braktisur shkollat, tha se nuk mund ta ofrojë këtë shifër, mirëpo ka rënie të këtij numri, pas strategjisë që është krijuar për njoftimin e braktisjes së shkollave. Ai tha se problemi kryesor qëndron te komunitetet dhe jo tek pjesa tjetër, mirëpo që edhe për këtë dukuri janë duke punuar shumë ndërkombëtarë, por që nuk është e lehtë.

Sa i përket cilësisë së librave shkollorë, ai tha se nuk është qëndrim i tij personal, mirëpo që pas studimeve është ardhur deri tek ky përfundim, që ka pasur gabime në libra shkollorë, diskriminim, përdorim të fjalorit diskriminues, mirëpo që është tentuar të përmirësohen. Ai tha se kurrikulat e reja, gjithashtu nuk përputhen me tekstet e vjetra, mirëpo që është duke u finalizuar udhëzuesi për mësimdhënës sesi t'i përdorin tekstet e vjetra, në përputhje me kurrikulën e re. Më tej, ai shtoi se kjo gjendje vlen vetëm edhe për këtë vit, pasi që nga viti i ri shkollor 2019/20, do të ketë libra të rinj shkollorë, që përpos cilësisë dhe standardeve, do të jenë në përputhje me kurrikulën e re.

Nga ana tjetër, për tekstet e shkollave profesionale, ministri theksoi se në radhë të parë, është më e rëndësishme të kemi mësimdhënës të mirë e pastaj edhe libra cilësorë. Ai tha se ministria është në bashkëpunim me GIZ-in, që nëse ka përputhshmëri, të përkthejë librat e shkollave profesionale nga Gjermania, sepse është e pamundur të ketë tekste cilësore vendore. Gjithashtu ai tha se edhe në ligjin e teksteve mësimorë është futur edhe librin alternativ, që do të vlejë për nivelin 1-12 dhe për nivelin e shkollave profesionale, që synon edhe rritjen e konkurrencës.

Lidhur me kërkesën për Institutin Shkencor, ai tha se ministria e përkrah dhe është shumë e interesuar, mirëpo që nuk ka shkuar më procedurë të rregullt për mundësinë për miratim në Qeveri. Sa i përket ndërtimit të shkollave të reja, sidomos në Komunën e Fushë-Kosovës, ai tha se në këtë komunë ekziston problemi i hapësirës dhe jemi detyruar që një projekt nga IPA për se ndërtimin e shkollës në Fushë-Kosovë, ta bartim në Prizren, për shkak të mungesës së hapësirës së mjaftueshme. Ai tha se në Fushë-Kosovë duhet që Ministria e Financave, së bashku me MASHT-in dhe komunën, të gjejnë një zgjidhje për këtë problem.

Sa i përket komunave me shumicë serbe, ministri tha se MASHT-i, fatkeqësisht nuk ka qasje në këto komuna dhe pa u zgjidhur problemi politik, kjo çështje nuk do të ndryshojë, mirëpo që planifikohet të krijohet një komision për zgjidhjen e këtij problemi.

Ismajl Kurteshi, falënderoi ministrin për këtë raportim. Ai tha se Komisioni për vlerësim të teksteve ka ekzistuar më herët dhe është konstatuar se ata kanë bërë shkelje ligjore, dhe bazuar në këtë, ministria ka të drejtën ligjore, për të bërë tërheqjen e këtyre teksteve, mirëpo që po cilësohet si problem politik.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,
Ismajl Kurteshi